



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.12, datë 18.10.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË SHËRBIMI DHE BANIMI 11, 12, 13, 14, 15, 16 KATE MBITOKË ME 4 KATE
PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “FORTUZI”, BASHKIA
TIRANË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “TDT & Partners” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë shërbimi dhe banimi 11, 12, 13, 14, 15, 16 kate mbitokë me 4 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Fortuzi”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “TDT & Partners” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Vecantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



SEKRETARI I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 18/03/2024